

Mbi Auditimin e Ushtruar në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë

Kontrolli i Lartë të Shtetit, ka përfunduar auditimin në Qendrën Spitalore Universitare , “Nënë Tereza”, Tirane, me objekt: “Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për vitin 2013”.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar me objekt “zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për vitin 2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 134, datë 24.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 221/13, datë 24.09.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Ogerta Manastirliu, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tirane.

Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, ku më kryesoret janë:

1. Tejkallime të numrit të punonjësve kundrejt organikave dhe strukturave të miratuara, emërime të punonjësve jashtë strukturës, emërimi i punonjësve me kontrata të përkohshme me punonjës të paspecializuar, duke plotësuar vendet vakante të specializanteve, në kundërshtim me strukturën e miratuar nga Këshilli Administrativ i ISKSH-së.

2. Në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, janë tejkalluar shpenzimet për pritje përcjellje dhe akomodimi të ekipeve të mjekëve të shoqatës “The Heart of Children”, ***duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 158, 160 lekë është.***

3. Në 9 raste të blerjeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve ***me vlerë rreth 13 milion lekë*** është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi brenda vitit kalendarik janë copëtuar fondet nën kufirin e ulët monetar prej 400,000 lekë, ***me qëllim shmangien nga procedurat standarte konkurruese të prokurimit, si:***

- Në 2 (dy) raste për kryerjen e shërbimit “deratizim, dezisektim, dizifektim” duke lidhur dy kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën t vjetore 1, 434, 003 lekë .

- Në 3 (tre) raste për kryerjen e shërbimit “Riparim aparatura mjekësore (skanerë dhe rezonanca manjetike” duke lidhur po tre kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 1,838,932 lekë .

- Në 5 (pese) raste për kryerjen e shërbimit “Ndërtim muri ndarës të korridoreve ,të arkivës dhe magazinës së barnave” duke lidhur 5 kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 2,268,341 lekë .

- Në 5 (pese) raste për kryerjen e shërbimit “ Riparim aparature mjekësore ” duke lidhur 5 kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 2,349,904 lekë .

- Në 3 (tre) raste për kryerjen e shërbimit “ Materiale mjekësore filma digital” duke lidhur 3 kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 1,433,700 lekë .

- Në 3 (tre) raste për kryerjen e shërbimit “ Riparim, sistem ,ftohje ngrohje me ciller, qarkullim uji” duke lidhur 3 kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën t vjetore 1,329,600 lekë .

- Në 2 (dy) raste për kryerjen e shërbimit “Materiale mjekësore, letër për EKG” duke lidhur 2 kontrata me të njëjtin operator ekonomi” në vlerën tvjetore 924,000 lekë .

- Në 2 (dy) raste për “ Blerje materiale mjekësore Filma Grafie” duke lidhur dy kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 959,592 lekë .

- Ne 2 (dy) raste për “Blerje kripë për zbutjen e ujit, shërbim për trajtim uji laborator” duke lidhur dy kontrata me të njëjtin operator ekonomik në vlerën vjetore 1,185,344 lekë .

4. Gjendja kontabël e inventarëve të pasurisë së QSUT, për shkak të mos mbajtjes së për një kohe të gjatë të inventarëve fizik, nuk pasqyron saktësisht lëvizjen e aktiveve të këtij institucioni si, blerjet, dhurimet, nxjerrjet jashtë përdorimit, kalimet kapitale, shitjet, mungesat apo tepricat që mund të rezultojnë nga kryerja e inventarëve fizik. Kështu në fund të vitit 2013, vlera e llogarisë 214 “Insta.tek.makineri e pajisje” sipas inventarit fizik (llogaria analitike) është 5,956,233,490 leke, ndërsa gjendja kontabël e kësaj llogarie (llogaria sintetike) po në fund të këtij viti është 6,163,282, 063, ***pra kemi një diferencë prej 207,048,573 lekë çka do të thotë se gjatë vitit 2013 janë blerë apo janë dhuruar pajisjeve dhe aparatura , të cilat nuk janë pasqyruar në inventarët e pasurisë së QSUT.***

5. Rezultojnë dy objekte të prishura midis viteve 2004-2006 gjatë ndërtimit të Spitalit Francez. Ndërkohë që këto dy objekte vazhdojnë të jenë në inventarin e QSUT.

6. Tre automjete me kanë kaluar në përdorim të Agjencisë së Shëndetit Rajonal (ASHR) edhe këto autovetura vazhdojnë të jenë në inventarët e QSUT.

7. Inventarët nuk janë mbajtur në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pasi:

-Nuk ka një përshkrim të plotë të aktivitetit, thuajse të gjitha përshkrimet janë tejet të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve.

-Informacioni për personin me përgjegjësi materiale është tejet i vaktë dhe disa nga kërkesat minimale të parashikuara në Udhëzimin e sipërcituar nuk kanë asnjë lloj pasqyrimi në regjistrin e aktiveve të QSUT.

-Në shumë raste janë vërejtur vlera shumë të mëdha materialesh konsumi që janë regjistruar si inventar ekonomik, d.m.th. materialet e konsumit nuk janë regjistruar në llogarinë “608” por janë hedhur në llogarinë 214 “Insta.tek.makineri e pajisje”.

-Inventari i pajisjeve informatike është i përfshirë në inventarin e pajisjeve dhe aparaturave. Këto lloje të ndryshme aktivesh kanë norma të ndryshme amortizimi, çka bënë të vështirë nxjerrjen e vlerës neto (të mbetur) të aktivitetit.

- Para fillimit të procesit të inventarizimit nuk është rakorduar paraprakisht me kontabilitetin për të dhënat e pajisjeve si në vlerë ashtu edhe në sasi, fakt që ka sjellë mungesë rakordimi jo vetëm në fizik por edhe me kontabilitetin për të dhënat e pajisjeve.

-Në inventarët e aktiveve ekzistojnë një sasi shumë të madhe të pajisjeve që janë jashtë funksionit apo jashtë përdorimit, por që vazhdojnë të mbeten në përgjegjësi materiale të personave që i kanë pasur dikur këto pajisje në përdorim. Të gjitha këto pajisje duhet grupoheshin në magazinën rikupero të QSUT, dhe shkarkoheshin nga përgjegjësia materiale personat që i kanë në ngarkim. Një proces i tillë do të ulte në maksimum riskun e këtyre aktiveve dhe më vonë do të bënte më të lehtë procesin e ndryshimit të destinacionit të këtyre pajisjeve.

8. Rezulton një gjëndje e lartë e barnave dhe medikamente të skaduara në depot farmaceutike, rreth 107 artikuj ***me vlerë 56,279,919 lekë***, e cila ka ardhur si pasoje e keqadministritimit apo pakujdesisë në planifikim e nevojave dhe shpërndarjes së tyre.

9. U konstatua se, 18 subjekte te cilet kane pasur kontarta per objekte te marra me qira në QSUT nuk kane derdhur detyrimet e qirase, per pasoje nuk kane hyre ne arken e shtetit duke **i shkaktuar buxhetit te shtetit dem ekonomik ne vleren 4,436,439 leke.**

10. Nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë, Energjetikës është lidhur me nje subjekti privat kontrate për dhënien me qira të tre hyrje-daljeve dhe gjashte sipërfaqeve të parkimit ne administrim te QSUT **me sipërfaqe te përgjithshëm 6,101 m², me vlere mujore 810,000 leke.** Këto hapësira publike nuk janë ndare dhe nuk janë përcaktuar si parkime private me vete, me vijëzime dhe me sinjalistike rrugore. Si pasoje e mos përcaktimit te këtyre sipërfaqeve te marra me qira, eshte lene e lire qe kontraktuesi te frytëzoje te gjithë sipërfaqen truall te lire te QSUT **duke mospaguar vleren qirase për sipërfaqet e shfrytëzuara tej sipërfaqeve te percaktuara ne kontrate.**

11. U konstatua se, për vitin 2013, por edhe për vitet e mëparshme, ne QSUT nuk është mbajtur dokumentacion për nxjerrjen e kostos direkte te një seance dialize edhe pse ne strukturën e saj ka një sektor qe merret me koston ne tërësi te shërbimeve spitalore. Nuk ka dokumentacion apo ndonjë reference ligjore ku te mbështetet dhe te argumentohet llogaritja e koston se një seance dialize. Për pasoje përlllogaritja e vlerave te kontratave te lidhura me spitalet private është bere ne mënyre spontane dhe apriori.

12. Gjate vitit 2013 janë realizuara 54 procedura me “Negocim pa botim paraprak te njoftimit te kontratës” **me vlere te përgjithshme rreth 1,280 milion leke.** Përzgjedhjen e kësaj e procedurë, Autoriteti Kontraktor e ka bere ne kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Sepse e ka argumentuar me nevojat emergjente duke u mbështetur ne kërkesat e shërbimeve te cilët si pasoje e mungesave te barnave te medikamenteve, materialeve te mjekimit, etj, kërkojnë furnizim për nevojat spitalore. Mirepo këto kërkesa nuk dokumentojnë apo argumentojnë krijimin e situatave emergjente, te cilat munde te kenë e ardhur për shkak te rrethanave te veçanta apo për arsye te nevojës ekstreme, te shkaktuar nga ngjarje te paparashikueshme. Por emergjencat e herëpashershme janë krijuar nga veprime apo mosveprime e vete Autoritetit Kontraktor.

13. Në datën 21.02.2013, është zhvilluar procedura e prokurimit me negocim pa njoftim paraprak te kontratës për “Mirëmbajtje dhe riparimin e 1 (një) rezonance magnetike dhe 3(tre) CT-Skaner GE, me fondi të përlllogaritur ne vlerën 87,576,000 leke. Në të njëjtën date është lidhur edhe kontrata me shoqërinë fituese, me vlere 84,936,000 leke. Shoqëria fituese e këtij tenderi nuk ka paraqitur dokumentacion qe te vërtetoje se është i regjistruar ne regjistrat përkatës profesional apo tregtar për te vërtetuar personalitetin e saj ligjor, ne kundërshtim të hapur me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Si pasoje e këtyre shkeljeve, shoqëria kontraktuese ka përfutuar padrejtësisht fonde buxhetore **duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dem ekonomik në vlerën 30,956,000 lekë.**

Për përmirësimin e gjendjes, KLSH i ka rekomanduar QSUT mjaft masa me karakter organizativ, shpërblimi të demit të shkaktuar në vlerën totale 35,500, 000 lekë dhe masa disiplinore. Kështu; është kërkuar marrja e masave disiplinore “zgjidhje e kontratës së punës” për 5 punonjës dhe masa disiplinore “vërejtje me shkrim” për 11 punonjës të tjerë. Gjithashtu, është bërë dy kallëzime penale ndaj 5 punonjësve te QSUT, me shkresa te Kryetarit te KLSH nr.221/14, date 24.09.2014 dhe nr.221/15, date 24.09.2014.

Shenim: Ky auditim u krye nga audituesit: Bashkim Arizaj, Ludmilla Sula, Dritan Kore dhe Alkida Llakaj, më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi z. Mehmet Kavaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i

Departamentit znj. Manjola Naco si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.